

Sadri Fetiu

## PESË VAJTIME NGA MALËSIA E MADHE

Vajtimet ose gjëmët janë krijime poetike që i përka-  
sin lirikës popullore familjare. Që nga origjina e lashtë e tyre, ato  
janë krijuar si pjesë e pandashme e riteve dhe e zakoneve të vdek-  
jes. Vajtimi për të vdekurin, si pjesë e traditës lidhur me kultin  
e vdekjes, që manifestohet me një varg ritesh e zakonesh mjaft të  
ngjashme, kryesisht të lidhura me jetën e përtejvarrit, me „jetën  
e amshuar”, dhe një varg besimesh të tjera, është dukuri e pranish-  
me në kulturën tradicionale të popujve të botës. Siç mësojmë nga  
Herodoti<sup>1</sup> edhe popujt e lashtë të Egjiptit e të Babilonisë, ashtu si  
edhe grekët, ilirët e të tjerët në periudhat e mëvonshme, besonin  
në kultin e të vdekurit dhe vdekjen e konsideronin vetëm si ndry-  
shim të mënyrës së vazhdimit të jetës. Ata të vdekurin e përcillnin  
me një varg ceremonish, me vaje e vajtime dhe me shumë veprime  
të tjera, që shprehnin dhembjen për aktin e ndarjes, si edhe dëshirat  
për sigurimin e kushteve sa më të mira për në botën tjetër.

Ndjenja e dhembsurisë për të vdekurin dhe besimi për jetën  
e pasvdekjes i ka ruajtur deri në kohën tonë gjurmët e lashta të tra-  
ditës së lidhjes së pashkëputshme me kultin e të parëve, me ruaj-  
tjen dhe nderimin e varrezave familjare si gjera të shenjta e të pa-  
cenueshme.<sup>2</sup> Krahas vajit dhe vajtimit, për njeriun e vdekur në she-  
një dhembjeje dhe nderimi në traditën e shumë popujve, pos riteve  
të tjera, praktikohet që vajtoret e vajtorët dhe njerëzit e afërt të  
tij të gërvishtin fytyrën, të rrahin kraharorin e gjumtyrët, të vi-  
shen me tesha të tjera, më së shpeshti me ngjyrë të zezë, të veshin  
rrobat së prapthi etj. Në disa raste, kur i vdekuri nuk linte fare  
trashëgimtarë, praktikohet që në shtëpinë e tij të vihen edhe shenja  
të ndryshme, të mbyllet dera me ferra, të rrëzohej oxhaku i shtëpi-  
së ose edhe të vendosej ndonjë leckë e zezë në formë flamuri mbi

<sup>1</sup> Petar Đ. Stojanović, *Običaji narodnog žaljenja i njihovi društveni korijeni u Crnoj Gori i Sjevernoj Albaniji*, Zbornik za narodni život i običaje, knj. 48, Zagreb, 1980, f. 170—171.

<sup>2</sup> Në bazë të traditës, si edhe të drejtës zakonore të shumë popujve, varrezat edhe sot e kësaj dite janë objekte që mbrohen edhe me ligje të shteteve.

pullazin e saj,<sup>3</sup> që të dëshmohej zija e përjetshme për familjen e shuar.

Tradita e lashtë e vajtimit e riteve dhe e zakoneve të tjera me rastin e vdekjes, me gjithë përpjekjet që të ndalohej si nga fetë monoteiste, ashtu edhe nga pushteti shtetëror në periudha të ndryshme historike,<sup>4</sup> ishte ngulitur thellë në vetëdijen e njerëve, prandaj e shoqëruar me shumë bestytini, pjesërisht është ruajtur deri në kohën më të re. Gjurmët e një tradite të hershme të vajtimeve dhe të riteve të tjera të vdekjes janë ruajtur deri sot edhe në viset shqiptare, sidomos në disa zona të Malësisë së Veriut.

Vajtimit shqiptare, goftë në formë të gjëmës kolektive, goftë „si të qarët me botë”, si vajtime individuale burrash ose grash, si në zonat e Veriut ose të Jugut, pastaj te arbëreshët e Italisë ose ata të Greqisë, me gjithë dallimet fare të vogla, i kanë ruajtur veçoritë e përbashkëta karakteristike.<sup>5</sup>

Vajtimi ose gjëma më e vjetër e burrave, që është karakteristikë specifike e vajtimeve shqiptare<sup>6</sup> e dokumentuar edhe me shkrim që nga fillimi i shekullit XVI, është vajtimi i Lekë Dukagjinit me rastin e vdekjes së Skenderbeut, të cilin e ka paraqitur në veprën e tij humanisti shqiptar, Marin Barleti.<sup>7</sup>

Duke u nisur nga supozimi për vjetërsinë e ciklit të këngëve të kreshnikëve, mund të pohohet se një nga vajtimet më të vjetra të grave në traditën shqiptare është ai i Ajkunës për të birin e saj Omerin.<sup>8</sup>

Elemente shumë të ngjashme me këto vajtime të vjetra, goftë sa i përket strukturës poetike, mjeteve të shprehjes, figuracionit, metrikës, goftë edhe përmbajtjes, botëkuptimeve për jetën e vdekjen, si edhe aspekteve të caktuara mitike lidhur me kultin e të vdekurit, si edhe kultin e të parëve, hasim pothuajse në krejt traditën e mëvonshme të vajtimeve shqiptare. Ruajtjen e formave shumë të lashta në vajtimet shqiptare e kanë vërejtur edhe studiuesit e huaj. Duke bërë krahasime ndërmjet vajtimeve shqiptare dhe malaziasë,

<sup>3</sup> Te pjesëtarët e besimit ortodoks për çdo rast vdekjeje lecka e zezë vihet në dyert e oborrit. Në kohët e fundit në derë të oborrit praktikohet që në vend të kësaj lecke të qëndrojnë pllakata për lajmin e vdekjes.

<sup>4</sup> Ligji romak i XII Tabelave, i vitit 451 dhe 450 para erës së re e ndalonte gërvishjen e fytyrës me rastin e vajtimit; Shih, P. Đ. Stojanović, *punimi i cituar*, f. 171.

<sup>5</sup> *Folklori shqiptar, disp.* I, UT, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1974, f. 168; P. Đ. Stojanović, *punim i cituar*, f. 169.

<sup>6</sup> Shih, Obrad Cicmil, *O tužbalicama (tužaljka)*, Prilozi proučavanja narodne poezije, knj. I, Beograd, 1934, f. 126.

<sup>7</sup> Ky autor i sjell këto fjalë si vajtim të Lekë Dukagjinit: „Mblijdhuni, mblijdhuni me vrap të gjithë, o princër e sundimtarë arbërorë. Sot u bënë copë dyert e Epirit dhe të Maqedhonisë, sot u rrëzuan muret dhe fortesat tona; sot fluturoi tërë forca dhe fuqia jonë; sot u përmbysën fronet e pushtetit tonë; sot u shua krejt së bashku me këtë njeri çdo shpresë e jona”. Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skenderbeut*, USHT, Institututi i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1964, f. 489.

<sup>8</sup> *Folklor shqiptar II, Epika legjendare*, vëll. I. Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966, f. 247—249.

të cilat kanë edhe elemente të ngjashme, Petar Gj. Stojanoviçi, pos tjerash, konstaton se „*vajtimet shqiptare kanë forma më arkaike*”.<sup>9</sup>

Në shumë treva në kohën tonë vajtimet kanë filluar të lihen pasdore dhe të zhduken. Sot janë fare të rralla sidomos vajtimet e burrave, të cilat janë ruajtur vetëm në disa zona të Malësisë së Veriut. Edhe në këto zona vajtimet e dikurshme kolektive nuk ekzistojnë më.<sup>10</sup> Në disa treva të jugut janë ruajtur disa forma të vajtimit në grup, ku në saje të radhitjes së vajtoveve fitohet përshtypja e ruajtjes së elementeve të theksuara dramatike.<sup>11</sup>

Zona ku është ruajtur më së miri tradita e vajtimit individual të grave dhe e gjëmës së burrave është Malësia e Madhe. Në pjesën e kësaj treve që u përket viseve të Hotit, të Grudës dhe të Kojës së Kuqit (në Mal të Zi) dhe atyre të Rrapshës së Hotit, të Kasratit dhe të Kelmendit (në Shqipëri), si në vajtimet e burrave, ashtu edhe në ato të grave, janë ruajtur deri sot elementet e shumta të botëkuptimeve të vjetra për kultin e të parëve dhe një varg rimesh e zakonesh lidhur me vdekjen. Mu në këtë trevë janë mbledhur në të kaluarën edhe vajtime që kanë vlera të larta poetike, siç është ai i Mare Smajles nga Gruda, e cila vajton vajzën e saj të vrarë, që njihet në letërsinë tonë popullore me titullin „*Oj lulja e ballit t' em-o!*”<sup>12</sup>

Respekti ndaj të vdekurit dhe familjes së tij, shprehja e ngushëllimeve, organizimi i ceremonialit të varrimit dhe ndihmat e tjera të bashkëfshatarëve të të vdekurit, paraqesin obligim të përgjithshëm shoqëror për të gjithë banorët e Malësisë, ku kushtet e vështira të jetës në të kaluarën e kishin zhvilluar deri në shkallën më të lartë ndjenjën e kolektivitetit për situatat e vështira të luftës për ekzistencë dhe për përballimin e çasteve të hidhura me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes. Kjo ndjenjë shprehej në mënyrë të veçantë në rastet kur personaliteti i të vdekurit shquhej për rolin e vet pozitiv, jo vetëm brenda vëllazërisë e fisit, por edhe tërë Malësisë.

Në të kaluarën shquheshin për fuqinë e veçantë artistike sidomos vajtimet për njerëzit e rëndësishëm të trevës së Malësisë që, në rrethana të traditës së nderimit të familjeve të njohura, për burrëri e trimëri, kishin fituar besimin e shumicës së banorëve të kësaj treve. Tone të përgjithshme të epikës heroike i përshkonin sidomos vajtimet ose gjëmat, të cilat u kushtoheshin burrave që kishin rënë në luftë, që ishin shquar për heroizëm e trimëri të veçantë. Karakteristika e epizmit që lidhet me traditën e trimërisë dhe me

<sup>9</sup> Petar Đ. Stojanović, *punim i cituar*, f. 169.

<sup>10</sup> Mirash Gojçaj, *Vdekja dhe vajtimet ndër shqiptarët e Malësisë së Rrethit të Titogradit*, Gjurmime albanologjike — Folklor dhe etnologji, III — 1973, Prishtinë, 1975, f. 102.

<sup>11</sup> Shin vajtimet e shënuara nga Shpresa Tuda, *Gjurmime albanologjike Folklor dhe etnologji*, III — 1973, Prishtinë, 1975, f. 229—244.

<sup>12</sup> *Visaret e Kombit*, vëll. II, Tiranë, 1937, f. 179—184.

kultin e të parëve edhe sot e kësaj dite është e pranishme në të gjitha vajtimet e burrave. Pothuajse nuk ka rast kur burri vajton, ose siç thuhet në këtë trevë „*thërret vaj*”, e nuk e përmend trimërinë e të parëve të familjes së të vdekurit.

Vajtimet e grave të kësaj treve dallohen, qoftë për nga struktura poetike, qoftë edhe për ndjenjat e theksuara të lirikës elegjiake. Ato i përshkon fryma e dhembjes për të vdekurin dhe për fatin e zi të familjes dhe të afërmeve të tij. Karakteristikë e përgjithshme e vajtimeve të grave është refreni i përsëritur pas çdo vargu, që në vetvete përmbledh krejt dhembjen dhe dëshpërimin për të vdekurin. Ky refren që përsëritet si element i melodisë karakteristike të vajtimit të grave, jo vetëm nga vajtorja e caktuar, por edhe nga të gjitha gratë që rrinë pranë arkivolit të të vdekurit, është edhe një shenjë për ruajtjen e gjëmës kolektive, prania e së cilës, pos në refren, vërehet edhe në disa elemente të tjera të vajit të përbashkët të grave.

Siç shihet nga vajtimet, që janë mbledhur në dy dhjetëvjetëshat e fundit,<sup>13</sup> elementet e reja në traditën e vajtimit të shqiptarëve të Malësisë paraqesin sidomos vajtimet për burrat që vdesin në mërgim, më së shpeshti në Amerikë, ku kanë shkuar shumë banorë të viseve të Hotit, të Grudës dhe të Kojës së Kuqit. Në këto raste edhe vajtimin ose gjëmën e burrave e përshkon ndjenja e theksuar elegjiake.<sup>14</sup> Në rastet kur familja e të vdekurit nuk ka mundësi që ta sjellë kufomën në atdhe, atëherë vajtimi bëhet para fotografisë së të ndjerit. Në këso rastesh, përveç ndjenjave të dhembjes, të mallit e të dashurisë për vëllanë, babanë, shokun, mikun e kushëririn e vdekur, dalin në pah edhe rrethanat sociale, që e kanë detyruar malësorin e kësaj ane për të marrë rrugën e mërgimit.

Ndërmjet vajtimeve të burrave dhe të grave të Malësisë së Madhe, me sa dimë deri sot, nuk ka vajtime konstante që do të shërbenin me rastin e vajtimit a gjëmës për njerëz të ndryshëm. Megjithatë brenda improvizimit të vajtimeve që u kushtohen njerëzve, të cilët kanë veçori të ngjashme, qoftë sa i përket moshës, pozitës në familje ose edhe në ambientin më të gjerë shoqëror, mund të gjenden edhe pjesë të vajtimeve që kanë marrë trajta të formulave, kryesisht për shkak se në to përdoren shprehje të njëjta metaforike, nëmë e mallkime, apostrofime, si edhe disa epitete pothuajse konstante, qoftë në vajtimet e burrave ose edhe të grave të kësaj treve. Kjo dukuri është më e dallueshme sidomos kur vajtohet i riu që vdes i pamartuar, kur, siç thuhet edhe në këto krijime „vdekë e dasmë” i bëhet në të njëjtën kohë, si edhe në vajtimet kur vdes i zoti i shtëpisë. Trajtën e formulave konstante e kanë marrë edhe pjesët e vajtimit me të cilat shprehet ngushëllimi. Ndërmjet vajtimeve të grave prania e shprehjeve të këtilla formulative është më e shpeshtë në ato raste kur vajtohet gruaja e re që lë pas

<sup>13</sup> Gjergj Hasanaj, *Malësori këndon, Këngë popullore nga shqiptarët në RS të Malit të Zi, Cetinë, 1971, f. 377—442.*

<sup>14</sup> *Po aty, Vajtimi për Tomë Lucën — Gojçaj, f. 401—405.*

vetit shumë fëmijë të mitur. Metaforat, nëmat dhe mallkimet, si edhe epitetet e trajtave konstante janë krijuar edhe në varësi nga afërsia e vajtores me personin e vdekur, p. sh. në rastet kur motra vajton të vëllanë, ose e ëma të birin etj.

Vajtoret dhe gjëmëtarët e talentuar të Malësisë së Madhe, siç shihet nga vajtimet e tyre, edhe në rastet kur i kanë përdorur formulat e këtilla figurative, janë përpjekur që të jenë sa më origjinalë, prandaj në këtë mënyrë e kanë pasuruar vazhdimisht shprehjen e vet me imazhe të reja poetike dhe brenda krijimtarisë së pasur letrare gojore kanë krijuar vajtime që kanë vlera të larta poetike.<sup>15</sup>

Brenda dallimeve ndërmjet vajtimeve të burrave dhe të grave, vlen të theksohet se gjëma e burrave ka kryesisht karakter recitativ, prandaj vargu i saj shpesh ka strukturë të atillë metrike, „*ku nuk ruhen rregullat e mirëfillta të poetikës*”.<sup>16</sup> Në vajtimet e grave, përkundrazi, ruhet, pothuajse pa asnjë përjashtim, struktura e rregullt metrike me elemente konstante të melodisë së vargjeve të gërshtuara me refrene.

\*

\*                      \*

Në qershor të vitit 1980 ekipi i Ekspeditës së Institutit Albanologjik të Prishtinës,<sup>17</sup> që mbledhi materiale të vlefshme gjuhësore, etnografike dhe folklorike në disa fshatra të Hotit, e ndau dhembjen më familjen e të ndjerit, mori pjesë në ceremonialin e varrimit të një të riu të kësaj ane dhe incizoi pesë vajtime. Në 23 qershor të vitit 1980 vdiq Nikollë Nikaj (Nikoliq), 27-vjeçar nga fshati Këshevë (Grudë), me profesion ndihmësmjeku, i njohur edhe si këngëtar i melodive argëtuese dhe popullore. Më 25 qershor, në një fushë afër Tuzit, u organizua ceremonia e varrimit të të ndjerit, „*dita e hatrit*” — si thuhet në këtë trevë, me ç’rast u bënë edhe vajtimet. Këtu „*thirren vaj*” katër burra dhe një grua.


Anëtarët e ekipit të Ekspeditës gjatë përcjelljes së ceremonialit, siç u konstatua më vonë, nuk kishin vërejtur asnjë element të ri, që nuk është paraqitur në një punim të Mirash Gojçajt<sup>18</sup> për ritet dhe zakonet e vdekjes në Malësi, prandaj këtu po sjellim vetëm vajtimet, të cilat u incizuan drejtpërdrejt gjatë ceremonialit në saje të

<sup>15</sup> Vajtimet, siç është ai me titull „*Oj lulja ballit t'em-o*” konsiderohen ndër krijimet e rralla të llojit të vet dhe mund të përfshihen në çdo antologji evropiane të poezisë popullore.

<sup>16</sup> *Folklori shqiptar, disp. I*, UT, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1974, f. 169.

<sup>17</sup> Ekipin e përbënin: Mehmet Halimi (dialektolog), Ramadan Ibrahimimi (etnograf), Ibrahim Goçi (leksikolog) dhe Sadri Feti u (folklorist).

<sup>18</sup> Përveç në punimin e cituar më parë të Mirash Gojçajt, ceremoniali i varrimit në Malësi është paraqitur hollësisht edhe në punimin e Fadil Mehmetit: *Zakone, rite e besime vdekjeje në Kelmend*, Etnografia shqiptare, IX, Tiranë, 1978, f. 333—358.



Pamje nga ceremoniali i varrimit të Nikollë Nikajt (Foto: Ramadan Ibrahim)

mirëkuptimit të familjes së të ndjerit dhe ndihmës së pakursyeshme të arsimtarëve të kësaj ane: Ndue Gjellaj dhe Fran Camaj.<sup>19</sup>

Këto vajtime po i sjellim të deshifruara nga bobina e magnetofonit, duke e ruajtur me përpikëri gjuhën origjinale të vajtorëve e të vajtores. Konsiderojmë se edhe në këto vajtime ruhen mjaft

<sup>19</sup> Familjes së të ndjerit dhe shokëve arsimtarë edhe në këtë rast u shprehim falënderim.

mirë elementet e traditës së lashtë, qoftë sa i përket strukturës poetike të këtyre krijimeve, qoftë edhe aspekteve të përmbajtjes, ku paraqiten shkaqet e vdekjes, virtytet e të vdekurit, tradita burrërore dhe e trimërisë së paraardhësve të tij, dhembja e familjes së pikëlluar dhe e farefisit të tij, si edhe e ambientit të përgjithshëm shoqëror të trevës së Malësisë. Në këto vajtime, ashtu si edhe në vajtimet më të hershme të traditës, ruhen edhe elemente të tjera, siç janë: forma e komunikimit me të vdekurin, besimi në kultin e të parëve, në takimin e të vdekurit në të ashtuquajturën „botë e vërtetë” me të afërmit e tij të vdekur më parë etj.

Këto vajtime, bashkë me vajtimet e tjera që janë shënuar më parë në këto vise, pos të tjerash, paraqesin edhe lëndë me interes për studime krahasimtare, sidomos kur dihet se shqiptarët dhe malaziasit edhe sot e kësaj dite e kanë ruajtur më mirë se të gjithë popujt e tjerë të Ballkanit traditën e vajtimit dhe një varg rimesh e zakonesh lidhur me vdekjen.

VAJTIMI I PARË PËR NIKOLLË NIKAJN  
NGA KËSHEVA E GRUDËS\*

Ej, ja sot, more Nikollë,  
E djalë i hjeshim, e djalë sokol!  
E vaj medet, fort e për t'ri  
T'marrka kjo mordë!  
E sot kur kqyrim na shoqi-shojn, 5  
Lott për faqe t'tanve na shkojnë  
E tye t'kjajtë ty, more Nikollë!  
E tye t'kjajtë ty e hallin tât:<sup>1</sup>  
E djalë n'votër nuk paske lâtë.<sup>2</sup>  
More djalë temel e punë sagllâm,<sup>3</sup> 10  
Djalë i dashtun me shoqni  
Si n'vêt t' pun's, ashtu n' kojshi.  
E djalë i zdriçim si ulli<sup>4</sup>  
E nishân djelsh e n'tanë Malsi,  
O kâtkatar e dyzenxhni;<sup>5</sup> 15  
Ke ktu kâtkâ e ke luajtë valle  
E ke marrë llurata ën festivalle.  
Por tash po t'kja' do tjera halle:  
Se shnosh e mirë tye nej ën shpi  
O smunja e râtë t'kap mrekuulli. 20

\* Këto pesë vajtime ruhen në *Arkivin e Institutit Albanologjik: Libri i Amzës* nr. rendor 449 me shënimin *Ekspedita e Hotit 1980, Bob, nr. 5, f. II.*

<sup>1</sup> tënd.

<sup>2</sup> lënë.

<sup>3</sup> i saktë, i sigurt.

<sup>4</sup> yll.

<sup>5</sup> gazmor, i hareshëm.

E me t'shpejt t'çuan ën heqimi,<sup>6</sup>  
 Por besa-besë nuk t'ban dobi.  
 E specialistat prej Beogradit  
 Me pështuo jetën ktij farë djalit. 25  
 Por kuj prej zotit i shkruhet deka,  
 S'prolojnë mjekt as apoteka.<sup>7</sup>  
 O t' ka nejtë nana përg'jat  
 Tye folë me ty,  
 Tye t'prek me dorë,  
 Por nuk ke mujtë me fol me gojë.  
 O kur tien,<sup>8</sup> pra, vllau e motra, 30  
 Janë habitë e s'din çka bâjnë.  
 Gjimon mal' e gjimon kodra,  
 Ne arkivol fut u ke arllë.  
 Ej kur nisen me t'vajtuo,  
 Tanë shoqnisë ju dha me kjajtë 35  
 Lott po shkojen porsì prruo  
 Për ket nanë, çì ty mâ s'ka!  
 Motra nisi me t'vajtuo,  
 Rrept e rresht tye me t'kukatë, 40  
 Ajo thote: Kuku muo,  
 Mirë na i dogje zemrat flakë!  
 Vllau tye t'kjajtë e tye t'lotuo,  
 Ai bërtet, pra, kuku muo!  
 Çou Nikollë, po t'pret rinia, 45  
 E n'festivall me shkuo me ktuo!  
 O Palinë Dedja, o zâna t'plastë!  
 Mos e qitë Nikollën jashtë,  
 Po prit e lutnje Shpejtrin bashkë!  
 Mos e qitë 'jat farë sokolit,  
 E n'vét' t' uladit,<sup>9</sup> 50  
 T'ka lanë plloçat<sup>10</sup> e gromofonit!  
 Ropt ty sot kanë me t'rrmuo<sup>11</sup>  
 E kanë m'u drell ën shpi me arllë,  
 Por prej deshprimit e llimës<sup>12</sup> sâte  
 Kanë m'u habitë 55  
 E nuk din derën ku e kanë.  
 Kanë me nëj n'kllupë<sup>13</sup> n'qosh t'oborrit,  
 Se i merr vaji tye menuo:  
 A thua çohesh naj herë prej vorrit

<sup>6</sup> mjeku, spitali.

<sup>7</sup> nuk ndihmojnë mjekët as barnatorja.

<sup>8</sup> dëgjuan.

<sup>9</sup> fëmija (evladi).

<sup>10</sup> pllakat, disqet.

<sup>11</sup> vorros.

<sup>12</sup> dhëmbjes.

<sup>13</sup> bangë.

E me arllë, me bjeseduo. 60  
I mjeri, o Nikollë, e nip, i mjeri!

Vajtoi: Nikë Gjeti — Arapaj, bujk 60 vjeçar  
nga fshati Muzhliçkë i Trijeshit.

## VAJTIMI I DYTË

E nuk muni Nish-o<sup>14</sup> me te vajtua, hëj, hëj!<sup>15</sup>  
E nana e motra tuo m' njig'jua,  
N'zëmër për ty po me dhëb mua.  
Kuku, Nikollë, si me t'vajtua ty, 5  
Kje nishani-o i djelve 'ri  
E Nish-o, dave n'krejt Malsi,  
Jo pse ke i bukur-o me t'pa,  
Por kje i mir-o me vepra!  
Eh, Nikollë, po to thonë tye,  
E s'ta kam pa t'shoqin-o me sye, 10  
E kaç sokol e pa madhshti- ,  
E me folë me plak e me t'ri.  
E kuku- Nish-o, dua me t'than-e,  
Kje gojâmël-o me gjithkan-e.  
E mjera nana ç'i t'ka rrit-e! 15  
E lshoj do lot-e prej mallit,  
Palina e Dodë Smajlit,  
Si t'dahesh prej këti farë nishânit!  
E kje i përmëtun n' krejt Malsi,  
E kuku, ty-o doktor-e 20  
E një sot po m'vet-e;  
Ti nuk ke madhnua<sup>16</sup>  
E gjithkujt i ke nimua  
E gjithkush t'ka békua  
E kuku, s't paskan nimua! 25  
O nishâni i djelve' ri,  
E si njig'jove nal-o me dry,  
E more zok-o sokolit,  
Bjeri shkjeml ktij arkivolit!  
E ti sokol-e si drit-e, 30  
E zene nanën ngryk-e  
E thuj nan's: nuk e kam dit-e,  
E kam marrë pushimin e ksaj vjet-e  
E dua te dajat e n'bjeshk-e,

<sup>14</sup> shkurtesë e emrit Nikollë.

<sup>15</sup> Refreni „hëj, hëj” përsëritet nga vajtorja dhe nga gratë e tjera pas çdo vargu.

<sup>16</sup> nuk ishe mendjemadh.

	A do n'buzë te detit.	3
	E kuku, o Nikoll-e,	
	E mirë ja thave zëmrën!	
	E kuku, më t'thanë dua,	
	A thu' m' je hise shkretua,	
	E emni yt-o s'ka me u harrua!	40
	Se përmëtej ti-e	
	E m'tanë Jugosllavi-e	
	E tanë Malsia u prish-e,	
	Diç Nikolla Nikoviqe!	
	O kuku, o Pashk-e,	45
	E ty zâna t'rafte!	
	E n'vëte-o <sup>17</sup> n'zëmër me t'ra,	
	E çu ban motra: Kuku vlla!	
	E zemrën ta ka tha!	
	E kuku, e more Zef-e,	50
	A pa ket vlla ke met-e,	
	E si doni me rrnuu?!	
	E Palinë zëmrën me ta coptua,	
	E Nishin ka' don me çua,	
	E prama si don me u bashkua,	55
	E pa Nikollën n'shpi?!	
	E medet, o zot-e,	
	A thua me u kalb-e n' tok-e?!	
	E gjynah, vallahi,	
	Ket nishan me blua n'dhe t'zi!	60
	E lark po tîhet brima,	
	E t'kjan motra, kto kushrina.	
	E t'kjan kta, Nisho, si t'pa',	
	E varzat e Toles, pra,	
	E Niko, s'u shkon ma,	65
	As nuk shkon ma me i pa,	
	As s'i shkon motrës vlla!	
	E bërtet nipja: Kuku daj-e!	
	E çfarë dajet pate,	
	E n' te tanë Malsi,	70
	E s' patë kush dajë si ti.	
	A Nisho — ulli	
	A çili Nisho ata sy,	
	E kqyr kush t'ka rrethua,	
	E çou ti me i pajtua,	75
	E nana s'muj ma me t'qitrua <sup>18</sup> !	
	Por â bij rodit, <sup>19</sup>	
	A qitro dit'n e sotit!	
	A kuku, t' thom, pra,	

<sup>17</sup> në vend.

<sup>18</sup> s'mund të qëndrojë.

<sup>19</sup> bijë e fisit, fisnike.

- Kur t'vin koha me u da, 98  
 A mâ mos me t'pa!  
 E Palinë dielli për ty mâ nuk xé!  
 E thotë motra: Kuku ne!  
 E kur t'vin-o- festa,  
 T' vin motra e kushrina, 85  
 Niko, ka me u tie brima!  
 A qitroni, o bija,  
 Se s'duron Palina!  
 A po t'kjan ty tezja,  
 E kuj nip si vetin, 90  
 E ti kujt si ke di,  
 E mjera tezja për dashni!  
 E te dajat po don me shkua.  
 E Nikollë t'tham vet-e,  
 E kur e lshove at spital-e, 95  
 E s'di ç'â' briti ç'ke gjall-e!  
 E u lshuan tanë doktort-e,  
 E kuku s'tkanë prollua,  
 E s'mujten jetën me ta pshtua!  
 E mos zot-o ma zi, 100  
 E ç'bani smunja n'ty,  
 E gjynash kje me ardh-o te ti!  
 E kuku, o farë nishânit,  
 Asaj i raft-i pika,  
 E si t'prishi ty, 105  
 E t' buerr<sup>20</sup> kaç i ri!  
 E kush â' ai ç'i nuk po kjan ty?  
 E t'kjan tanë kjo Malsi,  
 E krejt Mali i Zi.  
 E Nisho, duo me t'than-e, 110  
 E mjera sot kjo nan-e,  
 E të shoqin s'ja ke lan-e!  
 E mjera motra për ty,  
 Çi s'i shkon ma n'shpi,  
 E s'ta she' t'shoqin ty, 115  
 E mjera kjo për dashni!  
 Krah për krah me vlla,  
 Kudo kini shkua, kini da,  
 N'çdo pazar-e ç'kini ra;  
 E mirë zemrën va ke tha. 120  
 E po t'kjan me zëmr-e me lotë,  
 Nisho, s'â tye ra shi,  
 E Nal-o po t'kjan ty,  
 E t'kjanë nrrikullat, vallahi!  
 Eh, rubat m'jau çua palë, 125

<sup>20</sup> të humbi.

De t'bajn-o për kumar-e;  
 E çfarë kumare t'pate'!  
 A kuku, Niko, t'tham vet-e,  
 Po t'kjan tanë vllaznia,  
 E kryethymi i vllazne'! 130  
 A kuku, thirre Zefin,  
 E si don me rrnuu?!  
 E kuku i borgjlove,<sup>21</sup>  
 Hisen va shkretove!  
 E kuku t'kan lozua,<sup>22</sup> 135  
 E more zok sokolit,  
 E more lul' dasmorit,  
 E hjeshia e logut,  
 E dashnia e shokëve!  
 E kuku, je da prej ropve!<sup>23</sup> 140  
 E po t'tham Nikoll-e,  
 E thirri kta rop-e,  
 E motra e kushrina,  
 Thuju: Edhe pak pra,  
 Me ju do me u da, 145  
 E ma mos me u pa!  
 E kuku te tanë pra!  
 E tash u tham vet-e,  
 E zoti u dhashtë kivet-e!  
 E për ket farë nishânit, 150  
 E valla te tana malet...  
 A qitro, o Palin-e!  
 Edhe n'kjash s'ke me u korit-e.  
 E t'thom besa — besë,  
 T' forcoftë zoti mêt e kresë! 155  
 E tash u tham vet-e,  
 Kuku, përgjithmon-e  
 Ty t'pastë zoja<sup>24</sup> n'dor-e!

Vajtoi: Tereze Uçja-Gjelaj, shtëplake rreth moshës 50 vjeçare nga Dushiqi 1 Grudës

### VAJTIMI I TRETË

O i mjeri u' për ty, o sot Nikollë!  
 O dy tri fjalë u' duo me i folë:  
 O n'arkavol ti sikur mollë,  
 O tanë janë bashkë, gja s'prollojnë!  
 O vraft-e zoti, për njat orë! 5

<sup>21</sup> i shpenzove, i le borgj.

<sup>22</sup> të kanë përkdhelur.

<sup>23</sup> anëtarëve të familjes.

<sup>24</sup> Zoja e Bekuar, Shën Mëria.

Po ty si të muorr në dorë,  
 O me t'marrë jetën përgjithmonë!  
 O ti për nanë, ti sot p'a menove,  
 O dit'n e sotit e dishprove,  
 O zëmr'n e saj, o ja coptove! 10  
 E vllán, Zefin, e dishprove,  
 E vllaznin ti e zvetnove!  
 O je kên, Nikollë, ti djalë pas djalit,  
 Je kê' i nipi i Dodë Smajlit!  
 O njaj Dodë Smajli burrë daji, 15  
 E ka dhâ' jetën për mik t'ti,  
 E ka ditun kjo Malsi!  
 O ju Nikoviq-o, me u folë hak:  
 Armt e tuaja i latë me gjak,  
 E qysh nishânit e n' Kar'dak, 20  
 E yryçllkun<sup>25</sup> me kthye prap!  
 O ktu janë kênë burra e daji,  
 I kâ' njoftë i kâ' di,  
 E Marti' Hasi me mik t'ti,  
 E Nikollë Miri i thonë ati! 25  
 Pak po lshoj tash n'Malsi:  
 Shpija Nikoviqit gjed pas gjedit<sup>26</sup>  
 O gjithherë â dhânë për s'parit  
 Haxhametin<sup>27</sup> e Ali Hajdarit;  
 I ka njoftë mreti e ka ditë krali, 30  
 O me ksi burrash fiket konaku  
 E me shok tu liget bajraku!  
 O kush s'me thotë se jam terzua vetë:  
 Nikoviq, u dhasht zoti kivet!  
 E kjosh me zotin ti t'vertetë,  
 E t'gjalle' u dhashtë zoti kivet!<sup>28</sup> 35  
 I mjeri, o, për ty, i mjeri!

Vajtol: Dede Luli Kalaj, bujk  
 60 vjeçar, nga Kësheva e Grudës.

### VAJTIMI I KATËRT

O i mjeri, o more Nikolla,  
 E je kjen sokoli, pra, tër sokola!  
 E për ty e 'grata nana,  
 E i mjeri vllau,  
 E t' gratat motra! 5  
 Je kjën Nikollë porsi nishân

<sup>25</sup> privilegjet e rrëmbyara me forcë.

<sup>26</sup> Gjysh pas gjyshi.

<sup>27</sup> masakrin, të pabërën.

<sup>28</sup> fuqi, forcë, qëndresë (morale).

E gjithkush mirë për ty ka thanë.  
 E daji si ara n' mal  
 E Malsia po t' kjan të tănë,  
 Po t'kjan tănë ty kjo Malsi, 10  
 Se je kjën ën t' part saniteta,  
 E kâtkatar e t'Malit Zi,  
 E s'â lypë tjetri ën moshën tâte  
 Ma i mirë as i bukur  
 Me hi n'kishë, as ën xhami. 15  
 E 'jini kënë gjithherë shp'janika,  
 Nja mas tjetrit ushtarë t' zg'jedhun  
 E burra t'përmëtun.  
 Por kurrkâ s'duo me marrë për ëmën,  
 Se jini kënun shpatë mejdanit, 20  
 Je k' i nipi i Dodë Smajlit,  
 E nar tana punt, pra, pika e djalit!  
 Eh, përmët nana jote tanë ket narot:<sup>29</sup>  
 Mos mâ mani Nikollën për pa rrokë,  
 E raki pini ka disa gotë, 25  
 Se dekë e dasum po t'i ban sot!  
 E ty s't'kapi exheli<sup>30</sup> n'thëbër,  
 Por ën tru t'kresë e përmjeti n'zëmër!  
 I mjeri, u' o, i mjeri!

Vajtoi Prënë Kola — Kërçiqi,  
 bujk 35 vjeçar nga Koja e Kuçit.

#### VAJTIMI I PESTË

O i mjeri û' për ty, more Nikollë, t'thonë!  
 E djalë t'ri 'izet e shtatë vjeç  
 T'marrka deka, e të marrka mordja!  
 E i mjeri, o Nikollë, i mjeri o nip, 5  
 O i mjeri û' për ty, more stërnip,  
 Hisen tâte, pa t'keqe t'vllas yt,  
 Njati Zefit, e ke fikë!  
 E je kënun djalë i mirë  
 Me t'tana pun't e me t'tana pikë. 10  
 E mjera nana, njajo Palinë,  
 Ajo sot çka ka pritë!  
 More Nikollë, sot po t'kjan nana Palinë,  
 E po t'kjan vllau, Zefi,  
 Edhe motra, njajo Pashkë  
 E nuk â çudë, besa sot për ty 15  
 Nanë e vlla edhe motër e t'tanë me plasë!

<sup>29</sup> popull.

<sup>30</sup> vdekja.

More Nikollë, sokol sokolit,  
 Se je kënun me detyrë  
 Ën spital e t'Titogradit,  
 Ej tye i ba mirë e gjithkuj: 20  
 E malacakut edhe pazarit<sup>31</sup>  
 E punëtorit e ministrit e gjeneralit!  
 More Nikollë, se je kënun n'tânë Malsi  
 E mâ i bukur kâtkatar  
 Përkrye radet e magnetofonit 25  
 Edhe n'ploça t'gramofonit!  
 More Nikollë, e more nip,  
 E kur t'shkojsh n'at t'vërtetë<sup>32</sup>  
 E shumë t' mir't e ksaj shpi', e kti fisi  
 Ty kanë me të teshë; 30  
 Ka me t'teshë ty baba, Toma,  
 E ty fort ka me t'u gzua  
 E ma fort ka me t'u idhnua,  
 Se je kjê' i ri ti atje, besa, me shkua!  
 Kanë me t'teshë more Nikollë, 35  
 E dy daja e prej Trjeshit,  
 Ej te dy, besa, djel t'ri e djel sokola:  
 Ej-o, Nikolla Tata edhe Kolë Toma!  
 More Nikollë, n'jetë t'vërtetë,  
 Ty t'kjoftë pushimi e familjes sate 40  
 I kjoftë nderimi e përparimi!  
 E ksaj vllazni, e ksaj shpi'  
 I dhashtë zoti kivet!  
 Jo veç shpis' e vllaznisë,  
 Por për, ty o more Nikollë, 45  
 Ja dves hatrin tanë Malsisë!  
 I mjeri, o Nikollë, e nip, i mjeri!

Vajtoi: Mark Gjetë nga Koja e Kuqit.

<sup>31</sup> malësorit dhe kalimtarit të rastit.

<sup>32</sup> në jetën e amshuar, në jetën e pasvdekjes, sipas besimit fetar.

*Sadri Fetiu*

## CINQ LAMENTATIONS DE LA MALËSIA E MADHE

### Résumé

Les lamentations publiées ici ont été directement enregistrées le 25 juin 1980 lors de la cérémonie des funérailles d'un jeune homme. La région de la Grande Malësia, dont font partie les villages de Hoti, Gruda et Koja e Kuçit dans le Monténégro, est une des rares régions albanaises où se conserve la tradition des lamentations. En effet, dans beaucoup d'autres régions elles ont commencé à tomber dans l'oubli ou à disparaître. Dans ces contrées s'est aussi conservée la tradition des lamentations exécutée par les hommes, ce qui est fort rare, non seulement de nos jours mais aussi dans la tradition antérieure des autres régions albanaises.

Dans le cérémonial des funérailles comme dans les lamentations que nous publions il apparaît clairement que dans cette région, aujourd'hui encore sont conservés des éléments anciens du culte des morts, du culte des ancêtres et une série de coutumes et de croyances d'origine très ancienne. Ces lamentations témoignent de la continuité de la tradition car on sait que cette région est le berceau des lamentations de haute valeur artistique; elles font partie des meilleures créations de la littérature populaire albanaise. De nos jours encore, les lamentations des hommes s'interprètent sous la forme d'un récit et contiennent des éléments dramatiques qui sont la conséquence de l'atmosphère générale de deuil et de la façon poétique de dialoguer avec le défunt et les participants à la cérémonie des funérailles. Dans les lamentations des femmes les éléments lyriques sont davantage accentués. Ces récits ont une structure métrique régulière et s'interprètent accompagnées d'une mélodie déterminée et des refrains constants.

En plus de la qualité de leur valeur poétique, les lamentations les plus récentes de cette contrée fournissent une matière intéressante pour des études comparatives, surtout lorsqu'on sait que les albanais et les monténégrins ont mieux conservé que tous les autres peuples des Balkans la tradition des lamentations et une série de rites et coutumes en relation avec la mort.